

UDHËZIM

Nr. 308, datë 22.5.2017

PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE DHE QENDRËS SË TRAJNIMIT PRIVAT TË PUNONJËSVE TË SHPSF-SË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, neneve 5, 16, 20, 21, 23, 29, 37 dhe 38 të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe VKM nr. 301, datë 5.4.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, me qëllim unifikimin e rregullave për licencimin dhe funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së,

UDHËZOJ:

Kreu I Licencimi dhe certifikimi

A. Licencimi i subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

1. Licencimi i subjekteve të SHPSF-ve dhe subjekteve të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së bëhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Policia e Shtetit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve vendimin e miratimit ose refuzimit të kërkesës për licencim, bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL).

3. Licencat ndahen në:

a) Licenca e nënkategorisë 1.3.A, "Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.

b) Licenca e nënkategorisë 1.3.B, "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.

c) Licenca e nënkategorisë 1.3.C, "Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së", e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.

4. Licencat 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C janë pa afat.

5. Çdo subjekt fizik e juridik ka të drejtë të përfitojë njëkohësisht të tre nënkategoritë e licencave 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C, me kusht që për secilën nënkategori të ketë drejtues teknik më vete.

6. Në rast të largimit të drejtuesit teknik, titullari i subjektit të SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së njofton menjëherë strukturat e Policisë së Shtetit dhe brenda 15 ditëve duhet të aplikojë për certifikimin e drejtuesit të ri.

7. Subjekti i licencuar për SHPSF-të dhe Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së aplikon në Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB) për ndryshimin e drejtuesit teknik, sipas procedurave të përcaktuara për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

8. Titullari i subjektit të SHPSF-së dhe titullari i Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së duhet të fillojë veprimtarinë brenda 1 viti kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të licencës.

9. Personit të cilit i është hequr licenca e SHPSF-së dhe licenca Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, i lind e drejta për t'u pajisur me licencë të re pas kalimit të afatit trevjeçar.

10. Titullari i SHPSF-së, drejtuesi teknik dhe punonjësi i shërbimit nuk mund të jetë njëkohësisht punonjës i Policisë së Shtetit, i Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit apo punonjës i Policisë së Burgjeve.

11. Trajnuesit/instruktorët e Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së janë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, ish-punonjësit e Policisë së Shtetit apo Forcave të Armatosura, të pajisur me certifikatën për mësimdhënie të instruktorit/trajnuesit, lëshuar nga Akademia e Sigurisë.

12. Titullari i SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së nuk mund të jetë njëkohësisht titullar i më shumë se një subjekti të SHPSF-së (nënkategoria 1.3.A dhe 1.3.B) apo Qendër të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, nënkategoria 1.3.C.

13. Titullari i subjektit i pajisur me licencë të nënkategorisë 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C paguan tarifën e licencimit brenda 3 muajve nga data e lëshimit të

saj. Mospagimi i tarifës brenda afatit, sjell revokimin e licencës.

B. Kriteret për licencimin e Qendrës të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

1. Për pajisjen me licencë të nënkategorisë 1.3.C, subjekti duhet të plotësojë këto kriteret:

a) Të jetë i regjistruar në QKB si sh.a. ose sh.p.k. dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për këtë veprimtari.

b) Titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë 1.3.C.

c) Drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë 1.3.C. dhe të jetë me kohë të plotë pune.

d) Të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik.

e) Të ketë në pronësi/qira ambientin e Qendrës së Trajnimit Privat, e cila duhet të ketë ambiente mësimore, ambient palestër për përgatitjen fizike të punonjësve të SHPSF-së, të kompletuar me mjete dhe pajisje për përgatitjen fizike, vetëmbrojtëse dhe të ndihmës së parë, ambiente zyre për stafin mësimdhënës, për drejtuesin teknik dhe personelin mbështetës të Qendrës së Trajnimit Privat.

2. Qendra e Trajnimit Privat për t'u certifikuar duhet të ketë:

a) Jo më pak se 3 (tre) klasa mësimore me kapacitet deri 25 kursantë, e pajisur me mjetet e nevojshme didaktike-mësimore, që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m² për çdo kandidat.

b) Palestër me një sipërfaqe jo më pak se 60 m², e pajisur me mjetet e nevojshme për përgatitje force.

c) Ambient zyre për stafin mësimdhënës.

d) Ambient zyre për drejtuesin teknik dhe personelin mbështetës të QTP-së.

e) Zyra për administrimin e dokumenteve.

f) Ambiente për stafin mbështetës dhe për magazinimin e pajisjeve të QTP-së.

g) Programin mësimor, planet dhe tekstet mësimore sipas kurikulës, për përgatitjen e punonjësve të SHPSF-së, të miratuar nga Akademia e Sigurisë.

h) Nyje hidrosanitare ku të përfshijë: 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën.

i) Kompletimi me sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe shkalla të emergjencës në rastet kur ndërtesa është me shumë kate.

j) Kompletimi me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme për këtë qëllim.

k) Bazë të nevojshme materiale për mësimdhënie (kompjuter, printer, tabela, projektor etj.).

l) Të ketë poligon civil qitje.

m) Të ketë Rregulloren e Brendshme të Qendrës së Trajnimit Privat, në të cilën të jetë e përcaktuar mënyra e funksionimit të kësaj qendre.

- Numrin e grupeve mësimore që do të kualifikohen, numrin maksimal të kandidatëve për punonjës shërbimi për SHPSF për çdo grup mësimor, i cili të jetë jo më shumë se 25 kursantë.

- Titullin e dokumentit që do të lëshohet në përfundim të kualifikimit.

- Emërtimi i institucionit, numrin e telefonit personal të administratorit dhe të institucionit, adresën e institucionit dhe të postës elektronike.

- Listë e trajnimeve/trajnimet e specializuara/ vazhduese që ofrohen në këtë qendër trajnimi privat.

- Tarifat përkatëse dhe modalitetet e pagesave që do të kontraktohen me përfituesit e shërbimit.

n) Të këtë lidhur kontratë pune mes titullarit të QTP-së dhe trajnuesve të certifikuar për mësimdhënie nga Akademia e Sigurisë.

o) Listë e stafit drejtues, mësimdhënës dhe të dhënat mbi arsimimin përkatës të stafit mësimdhënës, së bashku me certifikatën përkatëse të lëshuar nga Akademia e Sigurisë.

p) Inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që ka në dispozicion dhe që është në funksion të kualifikimit dhe realizimit të kërkesave të programeve.

q) Kontrolli mbi plotësimin e kriterëve të vendosura për QTP-në bëhet nga komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit, me përfaqësues të Akademisë së Sigurisë, Drejtorisë së Përgjithshme për Sigurinë Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse.

r) Dokumentacioni i Qendrës së Trajnimit Privat, i përcaktuar në pikën 2 të shkronjës B, kreut I i këtij udhëzimi, administrohet në një dosje të veçantë dhe shqyrtohet nga Komisioni i Verifikimit dhe Kontrollit të QTP-së. Dosja e QTP-së së bashku me procesverbalin e verifikimit dërgohet në Komisionin e Shqyrtimit të Kërkesave për Licencim dhe Certifikim.

s) Qendra e Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së nuk mund të fillojë ushtrimin e aktivitetit të saj pa plotësuar kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.

C. Certifikimi i Titullarit, Drejtuesit Teknik dhe Punonjësit të SHPSF-së

1. Certifikata e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe Certifikata e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së ndahet në lloje sipas nënkategorisë së licencës dhe miratimi i tyre është kompetencë e Drejtorit të Policisë Shtetit, bazuar në mendimin paraprak të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL), në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

2. Certifikata e punonjësit të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike ndahet sipas nënkategorisë të licencës dhe miratimi i saj është kompetencë e Drejtorit Vendor të Policisë, ku ka vendbanimin punonjësi i shërbimit, bazuar në mendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim (KSHKC).

3. Aplikimi për pajisjen me certifikatë të titullarit të subjektit, drejtuesit teknik dhe punonjësit të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike bëhet vetëm në Zyrat e Shërbimit për Qytetarët, pranë drejtorive vendore të policisë dhe komisariateve të policisë në varësi të tyre.

4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik të SHPSF-së, si dhe e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa e punonjësve të shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të aplikimit.

5. Certifikata për titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik të SHPSF/QTP, si dhe punonjës in e shërbimit është vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritje.

6. Ripërtëritja e afatit të certifikatës për titullar subjekt/drejtues teknik bëhet duke bërë aplikim 90 ditë para mbarimit të afatit 4-vjeçar nga koha e dhënies së saj.

7. Ripërtëritja e afatit të certifikatës për punonjës shërbimi bëhet duke bërë aplikim 60 ditë para mbarimit të afatit 4-vjeçar nga koha e dhënies së saj.

8. Mosparaqitja e kërkesës për ripërtëritjen e certifikatës për titullar subjekt, drejtues teknik dhe

punonjës shërbimi brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim sjell mos ripërtëritjen e saj. Mos ripërtëritja e certifikatës brenda afateve të përcaktuara nuk e pushon të drejtën e aplikimit për pajisjen me certifikatë të re.

9. Personit të cilit i është hequr certifikata për titullar subjekt i QTP-së për Punonjës të SHPSF-së i lind e drejta që të aplikojë për certifikatë të re pas kalimit të afatit trevjeçar.

10. Personit të cilit i është hequr certifikata për drejtues teknik i QTP-së për Punonjës të SHPSF-së i lind e drejta që të aplikojë për certifikatë të re pas kalimit të afatit dyvjeçar.

11. Titullari i subjektit, drejtuesi teknik dhe punonjësi i shërbimit paguan tarifën e certifikimit brenda 3 muajve nga data e lëshimit të saj. Mospagimi i tarifës brenda afatit, sjell revokimin e certifikatës.

12. Drejtuesi teknik i SHPSF-së, i pajisur me certifikatë të nënkategorisë 1.3.A dhe 1.3.B, mund të ndryshojnë nënkategorinë e certifikatës me vendim të komisionit në Drejtorinë e Policisë Shtetit.

13. Drejtuesi Teknik i SHPSF-së dhe Drejtuesi teknik i QTP-së mund të ndryshojë subjektin duke kryer veprimet e aplikimit pranë QKB-së, ndërsa miratimi i ndryshimit bëhet me vendim të komisionit në Drejtorinë e Policisë Shtetit.

14. Punonjësi i shërbimit të SHPSF-së, i pajisur me certifikatë të nënkategorisë 1.3.A ose 1.3.B, mund të ndryshojë me kërkesë nënkategorinë e certifikatës, miratimi i së cilës bëhet me vendim të komisionit në Drejtorinë Vendore të Policisë.

D. Refuzimi për dhënien e Certifikatës dhe Licencës.

1. Refuzimi i kërkesës për pajisje me certifikatë të titullarit të subjektit, drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Policisë së Shtetit, në rast të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligjin 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

2. Refuzimi i kërkesës për pajisje me licencë të subjektit të SHPSF-së dhe subjektit Qendra të Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Policisë së Shtetit, në rast të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligjin 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

3. Refuzimi i kërkesës për pajisje me certifikatë për punonjës shërbimi bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Policisë Vendore, në rast të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligjin 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

4. Kundër vendimit të refuzimit për pajisje me certifikatë për titullar subjekti dhe drejtues teknik të SHPSF-së/Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së bëhet ankim në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), i ngritur në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, ndërsa kundër vendimit të refuzimit të pajisjes me certifikatë për punonjës shërbimi, ankimi bëhet në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), i ngritur pranë Drejtorisë Vendore të Policisë.

5. Kundër vendimit të refuzimit të kërkesës nga KSHA për pajisje me licencë, certifikatë të titullarit subjektit, drejtues teknik dhe punonjës shërbimit të SHPSF-së bëhet ankim në Gjykatën Administrative.

E. Dokumentet e certifikimit për titullarin e subjektit të SHPSF-së dhe titullarin e subjektit të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

1. Dokumentet për pajisjen me certifikatën e titullarit të subjektit të SHPSF-së:

a) Formular aplikimi dhe autodeklarimi.

b) Fotokopje e letërnjoftimit dhe certifikatës familjare.

c) Dokumenti që vërteton përfundimin e shkollës së mesme.

d) Certifikatë e gjendjes gjyqësore.

e) Certifikata e regjistrimit të subjektit, lëshuar nga QKB, së bashku me ekstraktin historik, ku të jetë e përcaktuar objekti i veprimtarisë së SHPSF-së dhe emri i drejtuesit teknik të këtij subjekti.

f) Të ketë të përcaktuar stemën dhe adresën e selisë së subjektit të SHPSF-së.

g) Raport mjeko-ligjor që provon aftësitë fizike dhe mendore, të lëshuar nga Komisioni Mjekësor.

h) Fotografi 2 copë me përmasa 4x6 cm.

i) Për ricertifikimin, titullari i subjektit të SHPSF-së dorëzon dokumentet e përcaktuara në pikën 1, germa a, b, e, g, h.

2. Dokumentet për pajisjen me certifikatën e titullarit të subjektit të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së:

a) Formular aplikimi dhe autodeklarimi.

b) Fotokopje e letërnjoftimit dhe certifikatës familjare.

c) Dokumentin që vërteton përfundimin e shkollës së mesme.

d) Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore.

e) Certifikata e regjistrimit të subjektit, lëshuar nga QKB së bashku me ekstraktin historik, ku të jetë e përcaktuar objekti i veprimtarisë së QTP-së dhe emri i drejtuesit teknik i këtij subjekti.

f) Të ketë të përcaktuar stemën dhe adresën e selisë së Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

g) Dokumentin e pronësisë/kontratë qiraje me afat 4 (katër) vjeçar të objektit Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

h) Akt verifikimi nga komisioni i plotësimit të kriterëve të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

i) Raport mjeko-ligjor që provon aftësitë fizike dhe mendore, të lëshuar nga komisioni mjekësor.

j) Fotografi 2 copë me përmasa 4x6 cm.

k) Për ricertifikimin, titullari i subjektit të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së dorëzon dokumentet e përcaktuara në pikën 2, germa a, b, e, g, h, i, j.

F. Dokumentet për pajisjen me certifikatën e titullarit të subjektit të SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, shtetasi i huaj.

1. Përveç dokumenteve të parashikuara në germën E, pika 1 dhe 2, plotëson edhe këto dokumente:

a) Të jetë i pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

b) Të jetë i pajisur me leje pune nga autoritetet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë.

c) Certifikatë e gjendjes gjyqësore (në gjuhën shqipe me apostile apo ekuivalente) nga vendet në të cilat ka pasur vendbanimin apo vendqëndrimin në 10 vitet e fundit (vetëm origjinale).

d) Dokument i lëshuar nga policia ku ka vendbanimin e përkohshëm shtetasi i huaj që vërteton se personi nuk ka rekorde kriminale.

2. Për ricertifikimin e titullarit të subjektit të SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, kur është shtetas i huaj, dorëzon dokumentet e përcaktuara në germën E,

pika 1, germa "i", pika 2, germa "f", si dhe në germën F, pikën 1, germa a, b, c dhe d.

G. Dokumentet për pajisjen me certifikatën e drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe të Qendrës së Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

1. Pajiset me certifikatën e drejtuesit teknik kandidati që plotëson këto dokumente:

a) Formular aplikimi dhe autodeklarimi.

b) Fotokopje e letërnjoftimit dhe certifikatë familjare.

c) Dokumentin shkollor që ka mbaruar arsimin e lartë policor ose arsimin e lartë ushtarak.

d) Certifikatë e gjendjes gjyqësore.

e) Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Policisë së Shtetit apo e Forcave të Armatosura, ku të përcaktohet grada që kanë mbajtur dhe motivacioni i daljes në lirim.

f) Dëshmi aftësie e përfundimit të trajnimit tekniko-profesional në Akademinë e Sigurisë, për kandidatët që kanë mbaruar arsimin e lartë ushtarak që nuk kanë qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit.

g) Raport mjeko-ligjor që provon aftësitë fizike dhe mendore, të lëshuar nga komisioni mjekësor.

h) Fotografi, 2 copë, me përmasa 4x6 cm.

2. Për ricertifikimin e drejtuesit teknik të subjektit të SHPSF-së dorëzohen vetëm dokumentet e përcaktuara në pikën 1, germa a, b, g, h.

H. Dokumentet për certifikim të punonjësit të SHPSF-së.

1. Pajiset me certifikatën e punonjësit të shërbimit kandidati që plotëson këto dokumente:

a) Formular aplikimi dhe autodeklarimi.

b) Fotokopje e letërnjoftimit dhe certifikatë familjare.

c) Dokumenti që vërteton përfundimin e shkollës së mesme.

d) Certifikatë e gjendjes gjyqësore.

e) Dëshmi aftësie profesionale për punonjës të shërbimit të SHPSF-së, lëshuar nga Akademia e Sigurisë ose QTP, për ata që nuk kanë qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit apo strukturat e tjera ligjzbatuese me grade policore ose ushtarake.

f) Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për motivin e daljes në lirim nga

strukturat e Policisë së Shtetit apo nga strukturat e Forcave të Armatosura.

g) Raport mjeko-ligjor që provon aftësitë fizike dhe mendore, të lëshuar nga komisioni mjekësor.

h) Fotografi, 2 copë, me përmasa 4x6 cm.

2. Për ricertifikimin e punonjësit të shërbimit të subjektit të SHPSF-së dorëzohen vetëm dokumentet e përcaktuara në pikën 1, germa a, b, g, h.

I. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL) dhe procedurat e shqyrtimit për certifikim dhe licencim:

1. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim ngrihet në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe përbëhet nga: a) Drejtori i Departamentit për

Sigurinë Publike kryetar

b) Drejtori i Rendit Publik anëtar

c) Shefi Sektorit të Shërbimit

të të Tretëve anëtar

d) Shefi i Sektorit në Drejtorinë Juridike anëtar

e) Specialist në Sektorin e Shërbimit

të të Tretëve anëtar

2. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Licencim/Certifikim mblidhet me kërkesë të kryetarit të komisionit, por jo më pak se një herë në muaj.

3. KSHKCL shqyrton dokumentacionin për subjektet që kanë aplikuar për certifikatë/licencim për SHPSF-të dhe certifikatë/licencim për QTP të punonjësve të SHPSF-së, duke kryer procedurat e verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për pajisjen me certifikatë të titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik.

4. Vendimet e komisionit të KSHKCL-së merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të komisionit.

Në rastet kur bëhet ricertifikimi dhe rilicencimi, së bashku me dokumentet, paraqitet edhe performanca e veprimtarisë së tyre, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Në rast se ndonjë nga anëtarët e KSHKCL-së ka lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me kandidatin për certifikim dhe licencim, ai tërhiqet nga komisioni dhe zëvendësimi i këtij anëtari bëhet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

6. KSHKCL, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për licencimin e subjektit, merr vendim për miratim/refuzim të licencës dhe ia paraqet për miratim Drejtorit të Policisë së Shtetit.

7. Vendimi i miratimit/refuzimit të licencës nga Drejtori i Policisë Shtetit publikohet online në Regjistrin Kombëtar të Licencave.

8. Vendimi i miratimit/refuzimit të licencimit i Drejtorit të Policisë Shtetit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nga QKB-ja. Kur për shkaqe objektive nuk është e mundur miratimi/refuzimi i licencës brenda afatit 30 ditë, me qëllim që mos të ketë miratim të heshtur, Drejtoria e Policisë Shtetit mund të kërkojë nga QKB-ja zgjatjen e afatit edhe 30 ditë të tjera.

9. Certifikata për titullar subjekti dhe drejtues teknik përgatitet në dy kopje, një prej të cilave i jepet aplikuesit, pasi ka bërë pagesën sipas tarifës së miratuar, kopja tjetër së bashku me dokumentet administrohet në Sektorin e Shërbimit të të Tretëve, për një periudhë 4-vjeçare dhe pas këtij afati arkivohet në sekretari.

J. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikimin e Punonjësve të Shërbimit (KSHKC) dhe procedurat e shqyrtimit për certifikim:

1. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për certifikim ngrihet në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe përbëhet nga:

a) Shefi i Sektorit të Rendit kryetar

b) Shefi i Sektorit për Krimet anëtar

c) Specialist armatimi anëtar

d) Specialist jurist anëtar

e) Specialist i Shërbimit të të Tretëve anëtar

2. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim mblidhet me kërkesë të kryetarit të komisionit, por jo më pak se dy herë në muaj.

3. KSHKC, pasi verifikon dokumentet e paraqitura për certifikim, në përfundim të procesit, përgatit mendimin paraprak dhe ia paraqet për miratim Drejtorit të Policisë Vendore. Certifikata për punonjës shërbimi është sipas modelit bashkëlidhur dhe bëhet pjesë e këtij udhëzimi.

4. Vendimet e komisionit për certifikim për punonjës shërbimi merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të komisionit, pasi shqyrtohet dhe analizohet dokumentacioni i paraqitur.

5. Certifikata për punonjës të shërbimit privat të sigurisë fizike përgatitet në dy kopje sipas llojit të nënkategorisë së licencës, një prej të cilave dërgohet në Zyrat e Shërbimit për Qytetarët ku është bërë aplikimi, ndërsa kopja tjetër administrohet së bashku me dokumentet në sekretari/arkiv të Drejtorisë Vendore të Policisë.

6. Afati kohor për lëshimin e certifikatës së punonjësit të shërbimit është 30 ditë nga data e aplikimit të kandidatit pranë Zyrave të Shërbimit për Qytetarët.

7. Kërkesa për transferim e punonjësit të shërbimit nga njëri subjekt i SHPSF-së te subjekti tjetër bëhet nëpërmjet drejtuesit teknik të SHPSF-së, duke aplikuar në Zyrat e Shërbimit për Qytetarët.

Specialisti i Seksionit të Shërbimit ndaj të Tretëve, brenda 5 ditëve nga aplikimi, njofton kërkuesin për miratimin/refuzimin, duke bërë ndryshimet përkatëse për këtë qëllim.

8. Kërkesa për transferim e punonjësit të shërbimit nga njëra DVP në tjetrën bëhet nëpërmjet drejtuesit teknik të SHPSF-së, duke aplikuar në Zyrat e Shërbimit për Qytetarët. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, fashikulli i punonjësit të shërbimit, kopjet e certifikatës, kopje të autorizimit për mbajtje arme dhe gjithë dokumentacioni që ka shërbyer për certifikim, dërgohet në DVP-në ku do të transferohet punonjësi.

9. Punonjësit e shërbimit privat të sigurisë fizike, të cilët janë pajisur me certifikatë, por nuk janë punësuar pranë subjekteve të SHPSF-së për shkaqe të ndryshme, kanë të drejtë të punësohen brenda afatit të certifikatës së lëshuar nga DVP.

K. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) dhe procedurat e shqyrtimit të ankesës 1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në Drejtori i Policisë Shtetit përbëhet nga: a) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm

i Policisë kryetar

b) Drejtori i Drejtorisë së

Standardeve Profesionale anëtar

c) Drejtori i Drejtorisë Juridike anëtar

d) Shefi i Sektorit të Rendit anëtar

e) Specialist në Sektorin e Shërbimit të të Tretëve anëtar

2. KSHA merr në shqyrtim ankesat e bëra nga titullari i subjektit/drejtuesi teknik i SHPSF-së ose QTP-së për Punonjës Shërbimi të SHPSF-së,

për masat administrative të parashikuara në nenet 39, 40, 41, 44 dhe 45 të ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

3. KSHA mbledhet me kërkesën e kryetarit, por jo më pak se një herë në muaj.

4. Ankuesi ka të drejtë të paraqesë dokumentacionin dhe ankesën pranë KSHA. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe dëgjimit të palës ankuese, komisioni merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të komisionit.

5. Në rast se ndonjë nga anëtarët e KSHA-së ka lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me ankuesin, ai tërhiqet nga komisioni dhe zëvendësimi i këtij anëtar bëhet me urdhër të Drejtorit të Policisë Shtetit.

6. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në Drejtorinë e Policisë Vendore përbëhet nga:

a) Zëvendësudrejtori i Policisë Vendore kryetar

b) Shefi i Seksionit për Trajnimet anëtar

c) Specialist -jurist anëtar

d) Specialist i Shërbimit ndaj të Tretëve anëtar

e) Specialist i Rendit Publik anëtar

7. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave merr në shqyrtim ankesat e bëra nga punonjësi i shërbimit i SHPSF-së për masat administrative të parashikuara në nenet 39, 42 dhe 46 të ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

8. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mbledhet me kërkesën e kryetarit, por jo më pak se një herë në muaj.

9. Ankuesi ka të drejtë të paraqesë dokumentacionin dhe ankesën pranë KSHA-së. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe dëgjimit të palës ankuese, komisioni merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të komisionit.

10. Në rast se ndonjë nga anëtarët e KSHA-së ka lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me ankuesin, ai tërhiqet nga komisioni dhe zëvendësimi i këtij anëtari bëhet me urdhër të Drejtorit të Policisë Vendore.

Kreu II

Trajnimi i personelit të SHPSF-së

A. Kurset dhe programet e trajnimit të personelit të shërbimit privat të sigurisë fizike dhe QTP-së.

1. Trajnimi i drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe QTP-së.

a) Trajnimi i drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat për Punonjësit e SHPSF-së bëhet në Akademinë e Sigurisë.

b) Personat që kërkojnë të certifikohen për drejtues teknik për SHPSF/Qendra e Trajnimit Privat kryejnë trajnimin përkatës. Programet, afatet e trajnimit, kushtet dhe kriteret për ndjekjen e trajnimit për personelin e SHPSF-së miratohen në Akademinë e Sigurisë.

c) Drejtuesit teknik të Qendrës të Trajnimit Privat që do të përfshihen në mësimdhënie, duhet të kryejnë edhe kursin e trajnimit "Për aftësimin e trajnerëve për mësimdhënie" në Akademinë e Sigurisë.

d) Trajnimi i Drejtuesit Teknik/Trajnerëve për mësimdhënie në Qendrën e Trajnimit Privat bëhet në Akademinë e Sigurisë. Programet e trajnimeve për trajnuesit e QTP-së hartohen dhe miratohen nga Akademia e Sigurisë.

2. Trajnimi i punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike.

- a) Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike trajnohet në Akademinë e Sigurisë ose në Qendrat e Trajnimit Privat (QTP), të licencuara për këtë qëllim sipas programeve të miratuara nga Akademia e Sigurisë.
- b) Programet për trajnime të specializuara për punonjës shërbimi të SHPSF-së miratohen nga Akademia e Sigurisë.
- c) Trajnimet e specializuara do të zhvillohen në Akademinë e Sigurisë dhe në Qendrën e Trajnimit Privat me kohëzgjatje 5 ditë në çdo 4 (katër) vjet. Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

3. Trajnimet e specializuara

Akademia e Sigurisë kryen trajnime të specializuara për:

- a) Përgjegjës shërbimi për SHPSF-të;
- b) Operator për Qendrën e Kontrollit;
- c) Truprojë për sigurimin fizik të personave;
- d) Punonjës për shoqërimin e vlerave monetare gjatë transportit;
- e) Shofer për drejtimin në mënyrë të sigurt të mjeteve të blinduara të shoqërimit të vlerave monetare;
- f) Instruktor për përgatitje zjarri për subjektet e licencuara "Për aftësimin teorik e praktik me armët".

Qendra e Trajnimit Privat kryen trajnime të specializuara për:

- a) Përgjegjës shërbimi për SHPSF-të,
- b) Operator për Qendrën e Kontrollit,
- c) Truprojë për sigurimin fizik të personave,
- d) Punonjës për shoqërimin e vlerave monetare gjatë transportit.

4. Trajnimet e vazhdueshme

- a) Programet për trajnime të vazhdueshme për drejtues teknik të SHPSF/Qendra të Trajnimit Privat hartohen dhe zhvillohen nga Akademia e Sigurisë. Trajnimi vazhdues për drejtues teknik kryhet çdo vit, me një afat kohor jo më me pak se 8 orë mësimore.

b) Programet për trajnime të vazhdueshme për punonjës të SHPSF-së hartohen nga Akademia e Sigurisë dhe zhvillohen çdo vit në Qendrat e Trajnimit Privat me një afat kohor jo më pak se 16 orë mësimore. Zhvillimi i këtij programi monitorohet nga Drejtoria Vendore e Policisë.

c) Të drejtën për mësimdhënie në Qendrat e Trajnimit Privat për punonjës të SHPSF-ve e kanë personat e pajisur me certifikatë si trajnerë për mësimdhënie nga Akademia e Sigurisë, përfshi këtu edhe Drejtuesin Teknik të QTP-së, i pajisur me certifikatë për mësimdhënie.

5. Personat të cilët janë kandidatë për trajnues në Qendrat Private të Trajnimit, të cilët janë certifikuar për mësimdhënie për armët e zjarrit, aftësitë vetëmbrojtëse, përgatitjes fizike dhe ndihmës së parë në institucionet e arsimit të lartë, si dhe ata që kanë kryer kurse të specializuara brenda ose jashtë vendit nga institucione të licencuara për programin përkatës, paraqesin dokumentacionin certifikues pranë Akademisë Sigurisë, e cila bën njohjen e vlefshmërisë së certifikimit.

6. Kontrolli i zhvillimit të programeve të trajnimit dhe testimit për Qendrat e Trajnimit Privat të bëhet nga Akademia e Sigurisë.

B. Zhvillimi i programeve të trajnimit

1. Akademia e Sigurisë dhe Qendra e Trajnimit Privat zhvillojnë trajnimin e personelit të SHPSF-së sipas programit të miratuar nga Akademia e Sigurisë.

2. Kandidatët për drejtues teknik për SHPSF-së dhe Qendra të Trajnimit Privat, të cilët janë ish-punonjësit të Policisë Shtetit, me gradë policore minimale të nivelit të parë drejtues, nuk kryejnë kursin e trajnimit për drejtues teknik.

3. Kandidatët për punonjës shërbimi të SHPSF-së, të cilët kanë statusin e ish-punonjësit të Policisë së Shtetit apo të strukturave të tjera ligjzbatuese, me gradë policore e ushtarake të nivelit zbatues, nuk kryejnë kursin e trajnimit për punonjës shërbimi të SHPSF-së.

C. Procedura e aplikimit për pajisjen me certifikatë të punonjësit të SHPSF-së

1. Kandidati ose Subjekti i SHPSF-së dorëzon pranë strukturave vendore të policisë dokumentacionin për pajisjen me certifikatë të punonjësit të SHPSF-së, sipas kreut I, germa H, pika 1, të këtij udhëzimi.

2. Kandidati ose subjekti i SHPSF-së, në kërkesën për certifikim përcakton vendin e kryerjes së trajnimit për pajisjen me Dëshmi Aftësie (Akademia e Sigurisë apo Qendra e Trajnimit Privat).

3. Para zhvillimit të trajnimit për pajisjen me dëshmi aftësie për punonjës të SHPSF-së, strukturat vendore të policisë brenda 15 ditëve përgatisin dokumentin "Vërtetim Besueshmërie" për çdo kandidat.

4. Lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe gëzojnë besueshmëri i dërgohet menjëherë Akademisë së Sigurisë/Qendrës së Trajnimit Privat, sipas përzgjedhjes që bën kandidati, për zhvillimin e kursit të trajnimit për punonjës shërbimi të SHPSF-së.

5. Pas përfundimit të kursit për pajisjen me Dëshmi Aftësie, kandidati dorëzon në strukturat vendore të policisë Dëshminë e Aftësisë dhe brenda 15 ditëve pajiset me certifikatë të punonjësit të SHPSF-së nga strukturat vendore të policisë.

6. Kërkesa për kryerjen e trajnimit për pajisjen me Dëshmi Aftësie mund të bëhet edhe nga aplikanti pranë Akademisë së Sigurisë ose subjektit të licencuar "Qendra e Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së", duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

a) fotokopje të letërnjoftimit;

b) formular aplikimi dhe autodeklarimi për dëshmi aftësie;

c) certifikatë të gjendjes gjyqësore;

d) raport mjekësor, që të vërtetojë që është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

e) fotografi (4 copë).

7. Kopjet e dokumenteve të përcaktuara në gerat "a", "c", dhe "d" duhet të jenë të noterizuara.

D. Procedura e trajnimit

1. Trajnimi i kandidatit për Drejtues Teknik të SHPSF-së/QTP-së bëhet sipas programit të trajnimit të miratuar nga Akademia e Sigurisë, i cili do të jetë jo më shumë se 3 ditë mësimore.

2. Trajnimi i kandidatëve për mësimdhënie në QTP bëhet sipas programit të trajnimit të miratuar nga Akademia e Sigurisë, i cili do të jetë jo më shumë se 5 ditë mësimore.

3. Trajnimi i instruktorëve për veprimtari me armët e zjarrit, për personat që do të punojnë në subjektet e licencuara "Për veprimtaritë e lejuara me armët", bëhet sipas programit të trajnimit të miratuar nga Akademia e Sigurisë, i cili do të jetë jo më pak se 5 ditë mësimore.

4. Trajnimi i kandidatëve për punonjës shërbimi SHPSF bëhet sipas programit të trajnimit të miratuar nga Akademia e Sigurisë, i cili do të jetë jo më pak se 10 ditë mësimore.

5. Trajnimi i aftësisë teorik e praktik për armën për punonjësit e shërbimit të SHPSF-së bëhet sipas programit të trajnimit të miratuar nga Akademia e Sigurisë, i cili do të jetë jo më pak se 5 ditë mësimore dhe kandidati duhet të ketë mbushur moshën 25 vjeç.

E. Testimi dhe pajisja me dëshmi

1. Testimi për pajisjen me dëshmi të kandidatit për drejtues teknik për SHPSF-të që nuk janë ish-punonjës të Policisë së Shtetit bëhet pas përfundimit të kursit të trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

2. Testimi për pajisjen me dëshmi të kandidatit për drejtues teknik/trajnerëve për mësimdhënës të Qendrës së Trajnimit Privat, përfshirë ish-punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit apo të Forcave të Armatosura, bëhet pas përfundimit të kursit të trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

3. Testimi për pajisjen me dëshmi të kandidatëve për punonjës shërbimi të SHPSF-ve, që nuk janë ish-punonjës të Policisë së Shtetit, bëhet pas përfundimit të trajnimit teorik dhe praktik në Akademinë e Sigurisë ose në Qendrat e Trajnimit Privat.

4. Për aplikantët që janë pajisur me "Dëshmi Aftësie për Punonjës Shërbimi të SHPSF-së" dhe që kanë mbushur moshën 25 vjeç, testimin për pajisjen me "Dëshmi për aftësimin teorik e praktik për armët" e kryejnë pas përfundimit të trajnimit në Akademinë e Sigurisë ose në

subjektet e licencuara për Aftësimin Teorik e Praktik për Armët.

5. Akademia e Sigurisë jep:

- a) Dëshmi për drejtues teknik për SHPSF-të,
- b) Dëshmi për drejtues teknik për QTP,
- c) Dëshmi aftësie për punonjës shërbimi të SHPSF-së,
- d) Dëshmi për aftësimin teorik e praktik për armët,
- e) Certifikatë për trajnuesit/instruktorët e QTP-së,
- f) Certifikatë për instruktorët për armët e zjarrit.

6. Qendra e Trajnimit Privat jep:

- a) Dëshmi aftësie për punonjës shërbimi të SHPSF-së.

7. Subjekti i licencuar për Aftësimin Teorik e Praktik për Armët jep:

- a) Dëshmi për aftësimin teorik e praktik për armët.

8. Akademia e Sigurisë dhe Qendrat e Trajnimit Privat për trajnimet e specializuara japin certifikatat përkatëse.

F. Komisionet e testimit

1. Në Akademinë e Sigurisë, komisionet e testimit për drejtues teknik të SHPSF-së, drejtues teknik/trajner për mësimdhënie të QTP-së për Punonjës të SHPSF-ve dhe për aftësimin teorik e praktik për armët, ngrihen me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, sipas procedurave standarde.

2. Në Qendrën e Trajnimit Privat, komisioni i vlerësimit të testimit për pajisjen me dëshmi të aftësisë për punonjës të SHPSF-së" ngrihet nga QTP.

3. Komisioni i vlerësimit të testimit përbëhet nga:

a) Drejtuesi Teknik i Qendrës së Trajnimit Privat,

b) Juristi i Qendrës së Trajnimit Privat,

c) Specialist për trajnimet në Akademia e Sigurisë.

4. Procesi i zhvillimit të trajnimeve dhe i vlerësimit të testimit në çdo Qendër të Trajnimit Privat për Punonjës të SHPSF-së kontrollohet nga Akademia e Sigurisë.

5. Pyetjet e testimit për pajisjen me dëshmi për drejtues teknik të SHPSF-së, drejtues teknik/trajner për mësimdhënie të QTP-së, për punonjës të SHPSF-ve dhe për aftësimin teorik e praktik për armët, si dhe procedurat e kryerjes së tyre

përgatiten nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, mbi bazën e përmbajtjes së moduleve të zhvilluara në kurset e trajnimit në Akademinë e Sigurisë apo Qendrën e Trajnimit Privat.

6. Vendimi i komisionit të kontrollit të vlerësimit për drejtues teknik të SHPSF-së/QTP-së, trajner për mësimdhënie të QTP-së, për punonjës shërbimi të SHPSF-ve dhe për aftësimin teorik e praktik për armët, nënshkruhen nga komisioni.

7. Akademia e Sigurisë ose Qendra e Trajnimit Privat, mbi bazën e vlerësimeve të komisionit jep dëshmi aftësie/certifikatë sipas formatit të miratuar në këtë udhëzim.

8. Dëshmia për drejtues teknik për SHPSF-të, drejtues teknik/trajner për mësimdhënie të QTP-së të punonjësve të SHPSF-ve dhe për aftësimin teorik e praktik për armët, plotësohet me të dhënat e shtetasit, me numër protokollit, siglën dhe vulën e Akademisë së Sigurisë, Qendrës së Trajnimit Privat apo Subjektit të licencuar për aftësimin teorik e praktik për armët.

Kreu III

Menaxhimi i shërbimeve

A. Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së

1. Titullari i SHPSF-së është përfaqësuesi ligjor i subjektit të licencuar dhe për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar ka të drejtë të lidhë kontrata për kryerjen e shërbimit nga SHPSF-të.

2. Kontrata ndërmjet palëve për kryerjen e shërbimeve nga SHPSF-të përmban:

a) Nënkatëgorinë e licencës, drejtuesin teknik dhe objektin konkret në ruajtje.

b) Numrin e vendrojave dhe numrin e punonjësve të shërbimit, duke llogaritur për 40 orë punë në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi, si dhe skemat e ruajtjes së objektit.

c) Rregulloren e brendshme të objektit nënshkruar nga palët, ku të përcaktohen rregullat për regjimin e hyrje/daljeve në objekt, ndriçimi, rrethimi, mjetet vëzhguese dhe sinjalizuese.

d) Paga e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

e) Për objekte të rëndësishme me vlera monetare, materiale e rrezikshmëri për sigurinë publike, përcaktimi i skemës të bëhet me

miratimin e titullarit të strukturës vendore të policisë.

f) Llojin e armatimit, pajisjet, mjetet e shërbimit, uniforma, simbolet dhe shenjat dalluese.

g) Afatin e kontratës, detyrimet financiare dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

3. Drejtuesi teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjigjet për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e kryerjes së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve, personave, veprimtarive social-kulturore sportive, fetare/politike, si dhe sigurimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.

4. Drejtuesi teknik i Qendrës së Trajnimit Privat është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjigjet për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e kryerjes së kurseve të trajnimit për punonjës shërbimi SHPSF.

5. Drejtuesi teknik i SHPSF-së dhe i Qendrës së Trajnimit Privat për punonjës të SHPSF-së punon me kohë të plotë pune dhe qëndron në detyrë deri në plotësimin e moshës së pensionit.

6. Drejtuesi teknik përcakton rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe përpilon plan-dislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes, si dhe plane të veçanta për ruajtjen e tyre për situata emergjente.

7. Drejtuesi teknik ose përgjegjësi i shërbimeve për çdo objekt në ruajtje mban librin e planëzimit të shërbimit dhe librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit. Në librin e planëzimit të shërbimit shënohen punonjësit e shërbimit sipas objekteve, vendrojave, oraret e shërbimit, ditët e pushimit javor dhe vjetor.

8. Libri i planëzimit të shërbimit dhe libri i marrjes dhe dorëzimit të shërbimit mbahen të sekretuar dhe ruhen në arkivin e SHPSF-së.

9. Drejtuesi teknik ose përgjegjësi i shërbimit hartojnë grafikun e pushimeve vjetore të punonjësve të shërbimit, duke e kombinuar me kërkesat e punonjësve dhe nevojat e shërbimit.

10. Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike për kryerjen e detyrave të ngarkuara nga ky ligj vepron me cilësinë e rojës, truprojes, operatorit, shoferit, verifikim sinjali, shoqërues i qenit të shërbimit, shofer/motoçiklist, si dhe të përgjegjësit të shërbimit.

11. Veprimtaria e SHPSF-së për ruajtjen e objekteve, personave, veprimtarive social-kulturore, fetare e sportive dhe për sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit për:

a) Ruajtjen fizike, rojë objekti;

b) Truprojë për ruajtjen e personave;

c) Ruajtjen objekteve me përdorim të sistemeve elektronike;

d) Punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;

e) Punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;

f) Përgjegjës shërbimi;

g) Punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;

h) Punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;

i) Shoqërues i qenit të shërbimit.

12. Mosha e punonjësit të SHPSF-së i certifikuar për nënkategorinë 1.3.B të jetë 25 - 50 vjeç.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, të ketë grup punonjësish jo më pak se 2 (dy) punonjës shërbimi për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

B. Mbikëqyrja dhe kontrolli i veprimtarisë së SHPSF-së dhe QTP-së

1. Veprimtaria e SHPSF-së dhe Qendra e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së mbikëqyret dhe kontrollohet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

2. Strukturat e policisë kontrollojnë veprimtarinë e SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat si më poshtë:

a) Kontrolli i aktivitetit të shërbimit të sigurisë fizike dhe Qendra e Trajnimit Privat nëpërmjet verifikimit të dokumentacionit që administrohet nga subjekti.

b) Kryeja e inspektimeve për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike dhe QTP të Punonjësve të SHPSF-së.

c) Kryejnë inspektime për mënyrën e kryerjes së shërbimit nga punonjësit e shërbimit të SHPSF-së.

d) Kryejnë inspektime për zbatimin e rregullave për sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit dhe mjeteve të blinduara.

ç) Inspektime për kriteret e mbajtjes, administrimit të armatimit, të mjeteve lëvizëse, pajisjeve të shërbimit, si dhe uniformën e punonjësit të shërbimit.

e) Kryejnë inspektime për mënyrën e administrimit të të dhënave dhe treguesve të punës të SHPSF-së, si dhe për funksionimin e Qendrës së Kontrollit.

f) Zbatimi i normave dhe rregullave në lidhje me mbajtjen dhe përdorimin e qenve të shërbimit.

ë) Kryejnë inspektime për zbatimin e programeve dhe procedurave të trajnimit të punonjësve të shërbimit në Qendra e Trajnimit Privat.

g) Strukturat e policisë për shkeljet e konstatuara të rregullave të shërbimit mbajnë procesverbal mbi konstatimin e shkeljes dhe ndjekin procedurat për marrjen e masave disiplinore dhe administrative.

3. Të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga niveli e funksioni, kanë për detyrë që gjatë përmbushjes së rregullt të detyrës të evidentojnë çdo informacion e shkelje që lidhet me veprimtarinë e paligjshme të SHPSF-ve dhe të personelit të tyre, duke e adresuar atë në strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

4. Funksionet e strukturave të Policisë së Shtetit që kanë kompetencë dhe detyrë të mbikëqyrin veprimtarinë e SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat sipas funksioneve janë:

a) Në Departamentin për Sigurinë Publike:

- Drejtori i Drejtorisë së Rendit Publik,
- Shefi i Sektorit të Shërbimit të të Tretëve,

- Specialist i Shërbimit të të Tretëve. b) Në Drejtorinë e Policisë Vendore:

- Shefi i Sektorit të Rendit Publik,
- Shefi i Seksionit të Policisë së Rendit,
- Shefi i Seksionit të shërbimit ndaj të Tretëve,
- Specialisti për SHPSF-të,
- Specialisti për Trajnimet në DVP,
- Punonjësi i Policimit në Komunitet (SPZ),

- Ndhmësspecialisti për SHPSF-të.

5. Strukturat e qendrore dhe vendore të policisë hartojnë plane të veçanta për kontrollin e veprimtarisë së SHPSF-ve dhe QTP-ve, i cili realizohet nga sektori përgjegjës për këtë shërbim, në bashkëpunim me strukturat e tjera të policisë.

6. Kur gjatë kontrolleve të ushtruara në veprimtarinë e subjekteve të SHPSF-ve dhe QTP-ve konstatohen shkelje administrative, përpilohet procesverbal për konstatimin e shkeljes në dy kopje. Procesverbali i konstatimit në momentin e plotësimit nënshkruhet nga të pranishmit, punonjësi i policisë dhe personeli i SHPSF-së dhe Qendrës së Trajnimit Privat, ku një kopje i lihet personelit të SHPSF-së/Qendra e Trajnimit Privat dhe tjetra i kalohet strukturës përgjegjëse për shqyrtim.

7. Procesverbalet e konstatimit për shkeljet administrative shqyrtohen në Komisionin e Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikimin (KSHKC) në DVP, i cili vendos masat administrative.

8. Në të gjitha rastet e informacioneve policore apo të konstatimeve nga kontrollet e ushtruara, që bëjnë fjalë për ndryshimin e të dhënave që përmban dokumenti i "Vërtetimit të Besueshmërisë" nga personeli i SHPSF-së, kryhen veprimet e nevojshme verifikuese e sqaruese dhe sipas rastit paraqiten për shqyrtim në KSHKCL ose në KSHKC.

9. Strukturat përgjegjëse për SHPSF-të në Policinë së Shtetit organizojnë punën për shkëmbim informacioni me strukturat e tjera ligjzbatuese, si: tatim-taksa, zyrat e punës, sigurimet shoqërore, prokurorinë, QKB etj., me qëllim shtimin e masave të kontrollit dhe verifikimin e veprimtarisë së SHPSF-së.

10. SHPSF-të në nivel qendror dhe vendor evidentojnë në regjistrin elektronik dhe fizik të dhënat e veprimtarisë së SHPSF-ve.

11. Performanca për veprimtarinë e SHPSF-së përgatitet nga strukturat vendore të policisë. Një kopje e performancës dërgohet në Drejtorinë e Rendit Publik, si dhe iu jepet subjekteve SHPSF kur kërkohet nga ana e tyre.

Kreu IV

Ruajtja dhe siguri i objekteve të sektorit bankar, siguri dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit

A. Ruajtja dhe siguri i objekteve të sektorit bankar

1. Objektet e sektorit bankar ruhen e sigurohen nga shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike të pajisura me licencë të nënkategorisë 1.3.A.

2. Ruajtja dhe siguri i objekteve të sektorit bankar nga SHPSF-të bëhet në bazë të kontratës ndërmjet palëve.

3. Skema e ruajtjes të objekteve të sektorit bankar, ku ruhen ose qarkullohen vlera të mëdha financiare, miratohet nga strukturat vendore të policisë.

4. Zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jo banka, që kryejnë veprimtari financiare me sportel, ruhen me punonjës shërbimi SHPSF ose sisteme elektronike alarmi, sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve.

5. Punonjësit e shërbimit të SHPSF-së që ruajnë dhe sigurojnë objekte të sektorit bankar dhe ata që kryejnë shoqërimin e vlerave monetare, të jenë deri në moshën 50 vjeç.

B. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit

1. Transportimi i vlerave monetare brenda dhe jashtë vendit kryhet nga subjektet SHPSF të nënkategorisë 1.3.B, të licencuara nga Policia e Shtetit, të cilat kanë në pronësi apo në përdorim mjete të blinduara të certifikuara sipas standardeve të BE-së, të projektuara për transportin e vlerave monetare, sendeve të çmuara, si dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së (përveç Bankës së Shqipërisë).

2. Subjektet SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B marrin në dorëzim vlerat monetare nga degët qendrore të bankave të nivelit të dytë vetëm në ambiente të mbyllura, të siguruara nga ndërhyrjet nga jashtë.

3. Subjektet e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B marrin në dorëzim vlerat monetare nga filialet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekte të tjera fizike/juridike duke marrë masa për të siguruar rrugëkalimin me sisteme monitorimi dhe roja fizike të SHPSF-së nga zyrat e tyre deri tek automjetet e SHPSF-së që do të bëjnë transportin e tyre.

4. Subjektet e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B, që transportojnë vlera monetare, materiale dhe sende të çmuara, përdorin automjete të blinduara që plotësojnë kushtet minimale teknike dhe të sigurisë sipas standardeve europiane EN 1063, EN 1522, EN 1523 ose me standarde të ngjashme me këto, vërtetuar me certifikatën përkatëse të prodhuesit, i projektuar për transportin e vlerave monetare, sendeve të çmuara, si dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së.

5. Procedurat për blerjen dhe administrimin e automjeteve të blinduara në përdorim nga subjekti që ushtron veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike, parashikohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

6. Policia e Shtetit lëshon autorizime për regjistrimin, ndryshimin e pronësisë dhe qarkullimin e automjeteve të blinduara të SHPSF-së, për personat që përdorin mjetin e blinduar sipas kontratës së lidhur me pronarin e mjetit, i shoqëruar me kartën e identitetit. Niveli i blindimit të automjetit evidentohet edhe në autorizimin e lëshuar nga Policia e Shtetit.

7. Numri i mjeteve të blinduara që duhet të ketë një subjekt i SHPSF-së i nënkategorisë 1.3.B, që merret me transportin e vlerave monetare të bankave të nivelit të dytë për të ushtruar veprimtarinë e saj, duhet të jetë jo më pak 10 (dhjetë).

8. Subjektet e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B, që bëjnë transportin e vlerave monetare, materiale dhe sende të çmuara, nënshkruajnë kontrata me subjektet fizike/juridike, publike dhe jopublike. Kontrata lidhet duke zbatuar ku shtet e përcaktuara në këtë udhëzim, ku përveç atyre të parashikuara, përfshihet dhe kategoria e mjeteve të blinduara që do të përdoren për shërbim, përdorimi i GPS, bojë ngjyrosje me kod për çdo bankë, kamerat e regjistrimit, sinjali SOS, radio komunikimi etj.

9. Procedurat, dokumentacioni dhe mënyra e kalimit të vlerave monetare nga subjekti financiar (banka) te SHPSF e deri në mjetin e blinduar, si dhe në destinacionin përfundimtar janë pjesë e kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve.

10. Mënyra e komunikimit dhe koha për njoftimin paraprak përcaktohen në kontratën ndërmjet palëve. Komunikimi për urdhrat e transportit të vlerave monetare do të kryhet me shkresë zyrtare (sekret bankar), në formë elektronike të enkriptuar ose kodifikuar, i cili ndërrohet në mënyrë periodike për arsye sigurie, nga persona të autorizuar të subjekteve që kërkojnë shërbim te Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve ose personi i autorizuar nga SHPSF-ja, duke bërë kodimin e objekteve të nisjes dhe mbërritjes. Urdhrat e lëvizjes për kryerjen e shërbimeve të transportit të vlerave mbahen në regjistrë elektronik ose fizik nga Qendra e Kontrollit ose personi i autorizuar nga SHPSF-ja.

11. Në rastet kur kryhen lëvizje të vlerave monetare, materiale dhe sende të çmuara për jashtë vendit, SHPSF-të njoftojnë përpara lëvizjes nga objekti në nisje sallën operative të DVP-së në zonën ku vepron eskorta, duke përcaktuar vendin e nisjes, kohën dhe destinacionin, targat e mjeteve dhe emrin e përgjegjësit të shërbimit.

- SHPSF-të duhet të njoftojnë Drejtorinë Vendore të Policisë edhe në rastet kur vlerësojnë se destinacioni brenda vendit dhe koha e lëvizjes paraqesin rrezik. Mënyrat e komunikimit të jenë të sigurta, me shkresë niveli konfidencial dhe elektronike të enkriptuara ose të kodifikuara, i cili ndërrohet në mënyrë periodike për arsye sigurie.

- Njoftimi i kryer ndaj DVP-së evidentohet në librin e Qendrës së Kontrollit të SHPSF-së nga është kryer njoftimi.

12. Eskortat që transportojnë vlera monetare qarkullojnë në rrugët urbane dhe interurbane, në hapësirën kohore brenda orarit zyrtar të përcaktuar në kontratën midis palëve, përveç rasteve të vonësive/defekteve etj., për të cilat njoftohen Qendra e Kontrollit të SHPSF-së dhe struktura vendore të policisë.

13. Eskortat nuk ndalojnë në asnjë rast gjatë lëvizjes me ngarkesë për transportin e vlerave monetare. Në rastet kur eskorta duhet kontrolluar nga strukturat e Policisë së Shtetit, njoftohet paraprakisht Qendra e Kontrollit të SHPSF-së, si dhe bëhet shoqërimi i eskortës në ambientet e komisaritit më të afërt të policisë, ku dhe do kryhet kontrolli.

14. Në të gjitha rastet e shoqërimit të vlerave monetare, drejtuesi teknik i SHPSF-së cakton përgjegjësin e eskortës dhe punonjësit e shërbimit. Përgjegjësi i eskortës bën instruktazhin, ndan detyrat, kontrollon mjetet e blindimit, pajisjet speciale, mjetet e komunikimit, armët e zjarrit, duke bërë shënimet në librin e shërbimit.

15. Subjektet e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B i lidhin kontratat me subjektet fizike/juridike, publike dhe jopublike, sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë udhëzim.

16. Përgjegjësi i eskortës së shoqërimit, para lëvizjes së eskortës për transportimin e vlerave monetare, ndalon mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve të komunikimit privat (celular) të punonjësve të SHPSF-së, përveç atyre të miratuara për transportimin e këtyre vlerave.

C. Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese

Për transportin e vlerave monetareve, materialeve dhe sendeve të çmuara dhe për transportin e punonjësve të SHPSF-së përdoren automjete të blinduara sipas kategorizimit të mëposhtëm:

1. Kategoria A: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë deri në 10.000.000 realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-3;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Jo më pak se dy punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve drejtues mjeti).

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së.

d) Sistem gjurmimi GPS dhe monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar, të pajisura me lexues targe.

2. Kategoria B: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë nga 10.000.000 lekë deri në 25.000.000 realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-3;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Jo më pak se tre punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve drejtues mjeti).

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së.

d) Sistem gjurmimi GPS dhe monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar, të pajisura me lexues targe.

3. Kategoria C: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë nga 25.000.000 lekë deri në 75.000.000 realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-4;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Jo më pak se katër punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve drejtues mjeti).

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së.

d) Sistem gjurmimi GPS dhe monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar të pajisura me lexues targe.

4. Kategoria D: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë nga 75.000.000 lekë deri në 150.000.000 realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-5 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-5;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Një automjet i blinduar BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së.

c) Jo më pak se pesë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (dy prej të cilëve drejtues mjeti).

d) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës.

e) Sistem gjurmimi GPS për të dyja mjetet në eskortë (çdo mjet të ketë nga 2 GPS).

f) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar të pajisura me lexues targe.

5. Kategoria E: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë nga 150.000.000 deri 550.000.000 lekë realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-6 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-6;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Një automjet i blinduar BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë), për transportimin e punonjësve të SHPSF-së.

c) Jo më pak se gjashtë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B 4 (dy prej të cilëve drejtues mjeti).

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare.

e) Sistem lidhje të vazhdueshme me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës, sinjali i njoftimit SOS.

f) Sistem gjurmimi GPS për të dyja mjetet në eskortë (çdo mjet të ketë nga 2 GPS).

g) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar të pajisura me lexues targe.

6. Kategoria F: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit me vlerë nga 550.000.000 lekë - 950.000.000 lekë realizohet me:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit nivelit BR-7 (me frëngji për hapje zjarri me armë):

- Niveli i blindimit të automjetit BR-7;

- Pjesa e vlerave monetare pa xham në faqet anësore dhe të pasme të mjetit.

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së.

c) Jo më pak se shtatë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (tre prej të cilëve drejtues mjeti).

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare.

e) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës, sinjali i njoftimit SOS.

f) Sistem gjurmimi GPS për të dyja mjetet në eskortë.

g) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda mjetit të blinduar, si dhe kamera të vendosura jashtë mjetit të blinduar të pajisura me lexues targe.

7. Transportimi i vlerave monetare mbi shumën 950.000.000 lekë, përveç masave të

parashikuara në kategorinë F, pikat "a" dhe "b" nga shërbimi privat i sigurisë fizike, strukturat e Policisë së Shtetit në territorin e të cilit do të lëvizë eskorta, të planifikojnë dhe të marrin masa shtesë sigurie. Niveli i masave shtesë që do të merren nga strukturat e Policisë së Shtetit përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

8. Transportimi i vlerave monetare të bankave të nivelit të dytë të planifikohet gjatë ditës nga ora 08.00 dhe të përfundojë në orën 16.00.

9. Sasia e vlerave monetare në valutë të huaj konvertohet me shumën në lekë sipas përshkrimeve të mësipërme, si dhe në bazë të kursit zyrtar të këmbimit valutor, sipas Bankës së Shqipërisë, ditën e transportit të vlerave.

10. Për transportimin e vlerave monetare, materialeve dhe të sendeve të çmuara sipas përcaktimeve të kategorive E dhe F, si dhe çdo transportim që do të kryhet për jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, drejtuesi teknik i SHPSF-së njofton në mënyrë të koduar 2 orë përpara lëvizjes DVP-në, në juridiksionin e së cilës do të bëhet transportimi i vlerave monetare.

Kreu V

Uniforma e shërbimit dhe dokumenti i identifikimit të punonjësit të SHPSF-së

A. Uniforma e shërbimit

1. Uniforma e shërbimit dhe elementet përbërëse të saj është e njëjtë për të gjithë subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike.

2. Uniforma e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike nuk duhet të jetë e njëjtë dhe e ngjashme me uniformën e strukturave të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese shtetërore.

3. Në uniformë të vendosen shenjat dalluese, emblemat, stema e subjektit dhe dokumenti identifikues i punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike.

4. Uniforma e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit.

5. Punonjësit privatë të sigurisë fizike gjatë kryerjes së shërbimit do të përdorin vetëm këto uniforma:

- uniforma shërbimi bazë,

- uniforma shërbimi operacionale,

- veshje civile.

6. Uniforma e shërbimit bazë përdoret nga punonjësit e shërbimit të subjekteve të pajisur me licencë të nënkategorisë 1.3.A, për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve shtetërore dhe private dhe për sigurimin e veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike.

7. Uniforma e shërbimit operacionale përdoret nga punonjësit e shërbimit të subjekteve të pajisur me licencë të nënkategorisë 1.3.B, për shoqërimin e vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.

8. Veshja civile përdoret nga punonjësit e shërbimit të nënkategorisë 1.3.A për kryerjen e shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të personave (truproja).

9. Për nevoja shërbimi, punonjësit e subjekteve private të sigurisë fizike mund të përdorin uniformë shërbimi operacionale dhe veshje civile, sipas përcaktimeve në kontratën e lidhur ndërmjet palëve.

10. Uniforma e shërbimit bazë dhe uniforma e shërbimit operacionale e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike të jetë ngjyrë kafe e errët, me kodin #C1608.

11. Elementet përbërëse të uniformës së shërbimit bazë janë:

- xhaketa;
- pantallona dimërore dhe verore, që përdoren sipas stinëve;
- këmbë me mëngë të gjata dhe të shkurtra që përdoren sipas stinëve;
- kapelë;
- kravatë;
- pulovër, jaka në formën e gërmës "V";
- këpucë verore, dimërore;
- xhup sintetik;

12. Elementet përbërëse të uniformës së shërbimit operacionale janë:

- a) kostum doku, xhakëtë, pantallona;
- b) kapelë, tip sport;
- c) bluzë me jakë të rrumbullakët, me mëngë të gjata e të shkurtra;

ç) bluzë pambuku, 2 kopsa, me mëngë të shkurtra;

d) këpucë me qafa (këmbale);

dh) xhup sintetik;

e) rrip multifunksional.

13. Elementet përbërëse të veshjes civile janë:

a) kostum civil (xhaketë, pantallona);

b) këmishë (mëngë të gjata e të shkurtra);

c) këpucë;

ç) kravatë;

d) xhup /pallto/ pardesy.

14. Në krahun e majtë të uniformës së shërbimit bazë dhe asaj operacionale dhe në ballin e kapelës vendoset stema e subjektit të shërbimit privat të sigurisë fizike. Në gjoks dhe në krahun e majtë të uniformës të punonjësit të shërbimit vendoset numri identifikues me katër karaktere për çdo subjekt SHPSF, duke filluar nga 0001 dhe në vazhdim sipas numrave në regjistrin e subjektit.

15. Rrethi i kapelës të uniformës së punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike të jetë me ngjyrë të kuqe. Në pantallonat poshtë qemerit në rafinë anësore, në gjatësinë e pantallonave, vendoset në mënyrë uniforme fileto tekstil, ngjyrë të kuqe, me përmasa nga 8 deri 10 mm. me qepje të përforcuar.

16. Punonjësi i shërbimit i privat të sigurisë fizike, gjatë kryerjes së shërbimit, duhet të ketë një paraqitje të jashtme dinjitoze dhe uniformë të rregullt (veshje civile).

B. Dokumenti i identifikimit

1. Shoqëria private e sigurisë fizike pajis çdo punonjës të shoqërisë me dokument identifikimi.

2. Punonjësi i shërbimit e mban dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës. Ai detyrohet ta paraqesë atë sa herë i kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë dhe organet e tjera ligjzbatuese.

3. Punonjësi i shërbimit pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me subjektin, detyrohet të dorëzojë dokumentin e identifikimit te drejtuesi teknik ose te titullari i shoqërisë.

4. Dokumenti i identifikimit i punonjësit të shoqërive private të sigurisë përmban:

a) stema kombëtare,

- b) stemën e shoqërisë,
- c) subjektin që përfaqëson,
- d) emër, atësi, mbiemër,
- e) numrin rendor,
- f) numrin personal ID,
- g) fotografi,
- h) vulën e s hoqërisë.

5. Forma e dokumentit të identifikimit të punonjësit të shoqërive private të sigurisë të jetë:

- a) material kartolinë e përforcuar,
- b) ngjyrë të bardhë,
- c) përmasat 10 x 6 cm,
- d) shkrimi ngjyrë e zezë.

Kreu VI

Mjetet, pajisjet e shërbimit dhe Qendra e Kontrollit të SHPSF-ve

A. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit

1. SHPSF-të për realizimin e detyrës vënë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjetet e mëposhtme:

- a) Automjetet të blinduar për transportim të vlerave monetare, që plotëson kushtet minimale teknike dhe të sigurisë, i cili përmbush standardet europiane EN 1063, EN 1522 dhe EN 1523, vërtetuar me certifikatën përkatëse të prodhuesit.
- b) automjetet shërbimi
- c) motoçikleta
- d) biçikleta

2. Në automjetet e shërbimit të shoqërive private të sigurisë fizike vendoset stema e shoqërisë, e miratuar nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

3. Shoqëria private e sigurisë fizike për realizimin e detyrës vë në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit si më poshtë:

a) armatim personal sipas ligjit "Për armët",

b) pajisje mbrojtëse elektrike,

c) bodygard spray,

d) jelek antiplumb,

e) hekura lidhës,

f) shkop gome,

g) elektrik dore,

h) radio ndërlidhjeje,

i) detektor metali që kalohet përmes tyre,

j) detektor dore,

k) maskë gazi,

l) dylbi,

m) helmetë,

n) rrip multifunksional.

4. Rregullat për mbajtjen, përdorimin dhe administrimin e armëve të zjarrit, mjeteve dhe pajisjeve në dispozicion të SHPSF-së janë sipas përcaktimeve në aktet nënligjore për veprimtarinë e lejuar me armët.

5. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit të shoqërisë përdoren nga punonjësit e shërbimit vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën shoqëria është licencuar.

6. Procedurat për administrimin e automjeteve të blinduara në përdorim nga subjekti që ushtron veprimtarinë e shërbimit

privat të sigurisë fizike, parashikohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

7. SHPSF-të, për blerjen e pajisjeve të shërbimit, paraqesin kërkesën në Zyrat e Shërbimit të Qytetarëve dhe pajisen me autorizim për blerjen e tyre nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë.

8. Automjetet dhe pajisjet e shërbimit të SHPSF-së të ruhen dhe sigurohen në vende të sigurta, në zbatim të kërkesave dhe akteve ligjore/nënligjore për këtë qëllim.

9. Vendosja dhe përdorimi në mjetet e shoqërisë private të sigurisë fizike, i sistemeve zanore shtesë të alarmit dhe atyre pamore me dritë vezulluese, përbën kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim. B. Qendra e Kontrollit

1. Shoqëritë private të sigurisë fizike që ushtrojnë aktivitet në një ose disa njësi administrative duhet të kenë Qendër Kontrollit në çdo njësi administrative (Qark), ku të tregohet adresa fizike dhe elektronike, si dhe stema e shoqërisë.

2. Subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike.

3. Qendra e Kontrollit pajiset me sistem ndërlidhës e radio-komunikim dhe radio-alarm, të cilat bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti në ruajtje.

4. Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale, ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.

5. Subjekti i shërbimit privat të sigurisë fizike, që ka në ruajtje objekte me sisteme elektronike, duhet të pajiset nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me autorizim individual.

6. Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet me komision nga Sektori i Rendit Publik në Drejtorinë Vendore të Policisë, me afat 4 vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Në aktin e miratimit, bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve.

7. Një kopje e Aktmiratimit të Qendrës së Kontrollit dërgohet në Sektorin e Shërbimit të Tretëve në Drejtorinë e Rendit Publik.

8. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së SHPSF-së pa Qendër Kontrollit të miratuar dhe funksionale.

C. Organizimi i shërbimit në Qendrën e Kontrollit

1. Qendra e Kontrollit kryen detyra për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e shërbimeve të SHPSF-së, për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike dhe sigurimin e vlerave monetare dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.

2. Për verifikimin e sinjaleve të alarmit të SHPSF-së organizojnë shërbim me grupe punonjësish të pajisur me armatim, me mjete speciale për ndërhyrje në raste emergjence, si dhe mjete për lëvizjen e tyre.

3. Qendra e Kontrollit ofron kapacitetin dhe potencialin e duhur teknik për realizimin e veprimtarisë të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

4. Qendra e Kontrollit realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimin në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrjen dhe verifikimin e sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet mënyrave të ndryshme si:

- nëpërmjet telefonit celular (GSM),
- nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID),
- nëpërmjet rrugëve valore (radio),
- nëpërmjet email-it.

5. Dokumentacioni që administrohet nga punonjësit e shërbimit të SHPSF-së në Qendrën e Kontrollit.

- Detyrat për funksionimin e shërbimit në Qendrën e Kontrollit.
- Libri i planëzimit të punonjësve të shërbimit të Qendrës së Kontrollit/ verifikimit të sinjaleve/objekteve në ruajtje.
- Evidencën e regjistrimit të sinjaleve të alarmit.
- Librin e shënimeve.
- Numërorin telefonik të drejtuesve të shoqërisë, të punonjësve të shërbimit sipas objekteve, të titullarëve të subjekteve që shoqëria ka lidhur kontrata dhe të shërbimeve të urgjencës dhe të Sallave operative të Policisë së Shtetit.
- Librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit.
- Evidenca e regjistrimit të bisedave telefonike me celularë.
- Kasafortë metalike për mbajtjen e armatimit dhe pajisjeve speciale.
- Shërbimi në Qendrën e Kontrollit kryhet nga punonjës shërbimi (operator) 24 orë në 24, me tri turne, duke respektuar javën 40 orë pune për secilin punonjës.

6. Pajisjet e Qendrës së kontrollit dhe të dhënat e siguruara nga përdorimi i tyre vihen në dispozicion sa herë që kërkohet nga Policia e Shtetit, organet e Prokurorisë, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kreu VII

Masat disiplinore dhe administrative

1. Për shkeljen e dispozitave të ligjit 75/2014 "Për Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", të cilat nuk përbejnë vepër penale, nga strukturat e Policisë së Shtetit jepen këto masa administrative.

a) Për subjektin e SHPSF-së.

- Vërejtje me paralajmërim për heqje të licencës.

- Heqje të licencës.

b) Për titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik.

- Vërejtje me paralajmërim për heqje të certifikatës.

- Heqje të certifikatës.

- Gjobë.

c) Për punonjësën e shërbimit.

- Vërejtje.

- Vërejtje me paralajmërim për heqje të certifikatës.

- Heqje të Certifikatës.

- Gjobë.

2. Të drejtën e dhënies së masave administrative, heqje licence dhe vërejtje me paralajmërim heqje licence për titullarin e subjektit, si dhe të drejtën e heqjes së certifikatës dhe vërejtje me paralajmërim për heqje të certifikatës për drejtuesit teknik e ka Drejtori i Policisë Shtetit, pas marrjes së mendimit paraprak të KSHKCL-së.

3. Të drejtën për dhënien e masës administrative dënim me gjobe, heqje të

certifikatës dhe vërejtje me paralajmërim për heqjen e certifikatës për punonjës shërbimi e ka Drejtori Vendor i Policisë, mbi bazën e propozimit paraprak të KSHKC-së.

4. Për shkeljet e konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit nga punonjësit e shërbimit, drejtuesi teknik ka të drejtë të japë për punonjësit e shërbimit masa disiplinore si "Vërejtje dhe vërejtje me paralajmërim". Masat disiplinore të dhëna nga drejtuesi teknik administrohen në dokumentacionin e subjektit SHPSF dhe raportohen në informacionet mujore që dërgohen në drejtorinë e policisë vendore përkatëse.

5. Konstatimi, shqyrtimi dhe gjykimi i shkeljeve administrative bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

6. Procesverballi i konstatimit të shkeljes administrative, si dhe çdo dokumentacion tjetër që është i vlefshëm gjatë fazës së shqyrtimit të shkeljes administrative, vihet në dispozicion sipas përkatësisë, strukturës së shërbimit të të tretëve në DVP.

7. Strukturat vendore të policisë, për rastet e shkeljeve të parashikuara në nenin 39, germa "a" dhe "b" dhe neni 40, pika 1, e ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", dërgojnë në KSHKCL në DPSH propozimet për masa administrative për çdo subjekt, vendimin e KSHKC-së, relacionin sqarues për masën që propozohet dhe procesverbalin e konstatimit.

8. Strukturat e shërbimit të të tretëve në DPSH dhe DVP, sipas përkatësisë dhe kompetencës, bëjnë shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur për shkeljet e konstatuara dhe mbi këtë bazë raportojnë në KSHKCL dhe KSHKC për dhënien masave administrative.

Kreu VIII

Dispozita përfundimtare

1. Me njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, personeli i subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe subjekti Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së.

2. Me kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë Publike dhe Akademia e Sigurisë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

3. Bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë dhe dokumentet sipas modeleve nga 1 deri në 22.

4. Procedura standarde për veprimet e punonjësve të SHPSF-së, për sigurimin dhe shoqërimin e vlerave monetare, materiale dhe sende të çmuara gjatë transportit, miratohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe duhet të bëhet deri në 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

5. Kompletimi i subjekteve SHPSF me mjetet e blinduara sipas standardeve të përcaktuara në këtë udhëzim të bëhet deri në 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

6. Kryerja e kurseve të trajnimit për pajisjen me Dëshmi Aftësie për punonjësit e shërbimit të SHPSF-së që janë aktualisht në marrëdhënie pune, si dhe ricertifikimi i tyre si punonjës shërbimi të SHPSF-së, të bëhet deri në 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

7. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 157, datë 1.4.2015, "Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Fatmir Xhafaj

